



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24 Prill 2021

Nr: 210

**U R D H Ë R**

**P Ë R**

**DORËZIMIN E PAJISJES SË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE (PEI),  
DHE TË KAMERËS SË PËR VIDEO RREGJISTRIM NË QENDRËN E VOTIMIT**

Në mbështetje të neneve 14 dhe 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

**U R D H Ë R O J M Ë:**

1. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) duhet t’i dorëzojë operatorit të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në qendrën e votimit të KZAZ-së përkatëse, pajisjen e identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI), si dhe kameran që do të vendoset në qendrën e votimit.
2. Në rast se operatori nuk paraqitet në KZAZ për të marrë PEI-n dhe kamerën, këto pajisje i dorëzohen kryetarit dhe sekretarit të KQV-së.
3. Operatori duhet të paraqitet në qendrën e votimit ku është caktuar nga KQZ-ja, në orën 06:00 të datës 25 prill, 2021.
4. Në rast se operatori nuk paraqitet në qendrën e votimit në orën e përcaktuar në pikën 3 të këtij urdhri, sekretari i KQV-së, në prani të kryetarit vendos në punë kameran e sipas udhëzimeve teknike që gjenden në këtë pajisje, si dhe e pozicionon atë sipas udhëzimeve të KQZ-së.
5. Në rast se operatori nuk paraqitet në qendrën e votimit ku është caktuar nga KQZ-ja deri në orën 06:45 të datës 25 prill, 2021, atëherë KQV-ja fillon menjëherë votimin në orën 7:00 dhe e zhvillon votimin pa ndërprerje deri në orën 19:00. Identifikimi i votuesve në këtë rast bëhet me listën e zgjedhësve të printuar të dërguar nga KZAZ-ja.



6. Paraqitja e operatorit pasi ka filluar votimi nuk e ndërpret për asnjë rast votimin e filluar dhe në këtë rast operatori nuk mund ta përdor PEI-n.
7. Në rast të mungesës së operatorit asnjë prej anëtarëve të KQV, përfshirë kryetarin dhe sekretarin, në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk kanë të drejtë të përdorin PEI-n. Në rastin kur PEI nuk është përdorur, ai dorëzohet pas mbylljes së procesit të votimit nga KQV-ja tek KZAZ-ja përkatëse.

**Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Lealba PELINKU**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

